

Burimet: deklarata F.M, FDH-13681; J. Martin-sen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Rahman (Sylë) Bojaj

(2.10.1947, shqiptar nga Kërnica/Krnjinca, komuna e Klinës/Klina, murator, tetë fëmijë)

Në fund të muajit korrik të vitit 1998, gratë dhe fëmijët e familjes Bojaj e braktisën fshatin [Kërnice/Krnjinca]. Këtë e bënë më vonë edhe burrat e kësaj familjeje. Rrahmani u strehua në pyll përmbi fshatin Turiqec/Turičevac [Skënderaj/Srbica]. Në datën 2.08.1998, Rrahmani shkoi në Tushilë/Tušilje [Skënderaj/Srbica], për ta gjetur të vëllain Ganiu dhe familjarë të tjerë që strehoheshin atje, por pa sukses, sepse atje gjendeshin mijëra refugjatë. Pas shtatë ditësh, vëllai i Rrahmanit, Ganiu, nisi ta kërkonte Rrahmanin. Nga i afërmi Naser Shatri ka mësuar se Rrahmani ka qenë tek ai më 3.08.1998 në Llaushë/Lauša, por nuk dinte se ku Rrahmani shkoi më vonë. Duke vazhduar kërkimin për të vëllain, Ganiu e takoi një ushtar të UÇK-së, i cili e çoi te një pyll përmbi fshatin **Rakinicë/Rakitnica**, ku e gjetën trupin e pajetë të Rrahmanit. Ganiu kishte vërejtur në trupin e të vëllait plagët nga plumbat, ndërkaq në kokë plagët nga thika. Në mbrëmje, Ganiu më ndihmën e dy familjarëve e kanë bartur trupin e Rrahmanit me një qerre në varrezat e Turiqecit/Turičevac, ku edhe e varrosën. Atje, Rrahmani prehet edhe sot.

Burimet: deklarata G.B, FDH-17977; FDH, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-31239.

Fatime (Zenel Zeqiri) Geci

(1931, shqiptare nga Llausha/Lauša, komuna e Skënderaj/Srbica, amvise, tetë fëmijë)

Mevlude (Hamzë) Geci

(18.02.1958, shqiptare nga Llausha/Lauša, komuna e Skënderaj/Srbica, amvise, e pamtuar)

Hamide (Isa Dajku) Teraku

(14.12.1956, shqiptare nga Vitaku/Vitak, komuna e Skënderaj/Srbica, amvise, gjashtë fëmijë)

Fatimja me familje jetonin në *Mëhallën Geci* në Llaushë/Lauša. Në fund të muajit korrik të vitit 1998, ata e strehuan nënën e

së rejës, Hamiden, dhe familjarët e saj, që e kishin braktisur Vitakun/Vitak. Nga ora 9:00, më 4.08.1998, filluan të dëgjoreshin të shtënat nga drejtimi i Skënderajt/Srbica, Vitakut/Vitak dhe fshatrave të tjerë përreth. Që të gjithë burrat i braktisën shtëpitë dhe u strehuan në pyllin përmbi fshatin Llaushë/Lauša. Fatimja me gratë dhe fëmijët u strehuan në bodrum. Rreth orës 13:00, të shtënat filluan të godisnin edhe shtëpinë e Fatimes [Llaushë/Lauša]. Plumbat i shponin muret dhe dyert e shtëpisë. Të frikësuar nga krismat, fëmijët ulërinin. Në ato çaste, Hamidja, vajza e saj Mevludja dhe Fatimja vendosën të dalin dhe të kërkonin vendin më të sigurt. Sapo dolën nga bodrumi, një predhë ka rënë në oborr duke i qëlluar për vdekje Hamiden dhe Mevluden, ndërkaq Fatimen e plagosi rëndë. Ajo disi zbriti në bodrum dhe u tha grave tjera se Hamidja dhe Mevludja kanë pësuar. Gratë i morën fëmijët me vete dhe dolën nga bodrumi, ndërkaq Fatimja mbe-ti vetëm. Dy muaj më vonë, djemtë e Fatimes u kthyen në fshat dhe i gjetën mbetjet mortore të Fatimes, Hamides dhe Mevludes në bërrilokun pranë ahurit. Po atë ditë, i varrosën ato në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata H.G, FDH-16652; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex. P01426, FDH-35363; *Bodies of Three Women Found Together with Animal Carcasses in Llausha*, pasqyra e lajmeve, KIC, 31.10.1998, FDH-29784; *Over 400 Villagers Up in Llausha for Eight Days Now*, pasqyra e lajmeve, KIC, 10.08.1998, FDH-29415; *Over 20 Albanians Killed in Latest Serb Offensive in Drenica*, pasqyra e lajmeve, KIC, 11.08.1998, FDH-29429.

Mustafë (Hazir) Geci

(18.09.1969, shqiptar nga Llausha/Lauša, komuna e Skënderaj/Srbica, punëtor, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Mustafa punonte në pazarin e Skënderaj/Srbica. Nga fundi i muajit korrik të vitit 1998, bashkëshortja, fëmijët dhe prindërit e tij kaluan te motra e Mustafës në Glllogoc/Glogovac. Ai ndenji në pronën e vet. Kur forcat serbe e sulmuan fshatin më 4.08.1998, Mustafa me disa të afërm të vet u strehuan në pyjet përmbi fshatin